



Prishtinë, 14 tetor 2016
Kodi i ZRRE-së: V_860_2016

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9 paragrafi 1, nënparagrafi 1.7, Nenit 15 paragrafi 1 nënparagrafet 1.11 dhe 1.12, Nenit 26, Nenit 28 paragrafi 2, nënparagrafi 2.10, Nenin 30 dhe Nenin 32 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 4 dhe 6 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë;
- Aplikacionin për Licencim të Aktivitetit të Furnizimit me Energji Elektrike të dorëzuar në ZRRE me datë 28.04.2015 nga ndërmarrja "HEP – KS" SH.P.K, adresa: Luan Haradinaj, Hyr. 1-2, Nr. 21, Prishtinë, Republika e Kosovës.

Në seancën e mbajtur me datë 14 tetor 2016, nxori këtë:

VENDIM

- I. **I LËSHOHET** Licenca për furnizim me energji elektrike ndërmarrjes "HEP – KS" SH.P.K, me numër licence ZRRE/Li_43/15 për periudhën nga data **14 tetor 2016 deri 13 tetor 2021**.

Arsyetim

- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 28.04.2015 ka pranuar Aplikacionin me dëshmitë përkatëse për Licencim të aktivitetit të furnizimit me energji elektrike në Kosovë nga ndërmarrja "HEP – KS" SH.P.K.
- ZRRE ka vlerësuar se ndërmarrja në fjalë ka vepruar sipas udhëzimeve të ZRRE-së dhe kërkesave të parapara në Aplikacionin për Licencim të aktivitetit të furnizimit me energji elektrike.
- Sipas Nenit 8.1 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, ndërmarrjet që aplikojnë për Licencim në ZRRE duhet të njoftojnë përmes gazetës palët e interesit se kanë dorëzuar një aplikacion në ZRRE për Licencë të Furnizimit me energji elektrike dhe se ai aplikacion është në fazën finale për marrje të licencës. Palët e interesit kanë të drejtë të kundërshtojnë aplikacionin, nëse dëshmojnë për ndonjë parregullsi të tij.




- Ndërmarrja “HEP KS” Sh.p.k me datë 29 korrik 2015 ka publikuar Njoftimin në gazetë, në pajtim me paragrafin e sipërpërmendur.
 - ZRRE pas vlerësimit të aplikacionit dhe dëshmime tjera të bashkangjitura aplikacionit të ndërmarrjes “HEP-KS” SH.P.K, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.
 - ZRRE, në përputhje me Rregullin për Licencim, merr një vendim formal për secilin aplikacion për Licencë brenda nëntëdhjetë (90) ditësh kalendarike, nga data kur aplikacionin e konsideron të kompletuar. Në rastin konkret ZRRE nuk ka mundur të veproj sipas afateve të përcaktuara me Rregullin për Licencim sepse, fillimisht Bordi i ZRRE-së ka qenë jo komplet si rezultat i mos emërimit të anëtarëve të rinj nga Kuvendi i Kosovës, e pastaj edhe si rezultat i mungesës së rregullave: Metodologjisë për llogaritjen e çmimit të jo-balancës dhe çmimit të Kompensimit, dhe Rregullës për ndërrimin e Furnizuesit, që janë të domosdoshme për funksionimin normal të aktivitetit të furnizimit me energji elektrike. Rregullat në fjalë janë hartuar dhe finalizuar dhe aprovuar nga ZRRE.
- II. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
- III. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.


Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.


Vendimi i dërgohet:


- Të licencuarit “HEP – KS” SH.P.K, dhe
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji

Bordi i ZRRE-së


Krenar Bujupi, U.D. kryesues


Arsim Janova, anëtar


Qemajl Mustafa, anëtar


Besim Sejfiqaj, anëtar